



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 213/9 prot.

Tiranë, më 23. 12. 2024

V E N D I M

Nr. 319, datë 23. 12. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 181, datë 06.09.2024, e M. Y., kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Fier (DVP Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,³

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “Më datë 06.08.2024 kam aplikuar për të vazhduar studimet e larta në degën Siguria dhe Hetimi, Bachelor në Akademinë e Sigurisë Tiranë. Pasi kam kryer testimet fizike, psikologjike dhe ato shëndetësore, më datë 25.08.2024 është publikuar “Lista sipas rendit zbritës të rezultateve të arritura për pranimet në programin Bachelor në Akademinë e Sigurisë”, ku unë jam renditur i 6-ti me ID maturanti 241317100121, me 89.22 pikë. Më datë 29.08.2024 në faqen e Policisë së Shtetit është publikuar “Lista përfundimtare e rezultateve për të gjitha fazat e konkurimit”, listë në të cilën ID-ja ime nuk ndodhej. Më datë 30.08.2024 shkova te Akademia e Sigurisë Tiranë me dokumentacionin përkatës për tu regjistruar pasi mendova se mund të ketë ndodhur ndonjë ngatërresë nga ana e tyre për heqjen e emrit tim nga lista e kandidatëve fitues. Pasi pyeta drejtorin

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Ankuesi ka përfshirë tek çdo shkak tjetër, të drejtën për arsimim.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

e Akademisë se cili është shkaku i skualifikimit tim nga lista fituese, ai më është përgjigjur: “Ju jeni skualifikuar pasi Vërtetimi i Besueshmërisë është negativ nga ana e Komisarariatit të Policisë Mallakastër, ky është shkaku i skualifikimit dhe ju nuk mund të rregjistroheni”. Arsyen e skualifikimit ia kam kërkuar të ma japin në rrugë zyrtare (me shkrim) por ai më tha se për këtë duhet ti drejtohesha Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose Komisarariatit të Policisë Mallakastër. Kështu bëra dhe në datë 30.08.2024 i kam kërkuar përgjigje Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbi arsyen e skualifikimit tim nga lista e kandidatëve fitues.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme po në datë 30.08.2024 më është kthyer përgjigje me e-mail se “Ju nuk plotësoni kriterin e besueshmërisë”.

Në datë 30.08.2024 i kam bërë kërkesë Komisarariatit të Policisë Mallakastër për të më sqaruar cilat janë shkaqet apo problemet që unë kam me ligjin për të cilat ju jeni bazuar për përpilimin e një Vërtetimi Besueshmërie Negativ (I papërshtatshëm) ndaj meje për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë. Në datë 03.09.2024 nga Komisarirati i Policisë Mallakastër më është dhënë përgjigje se: “Vërtetimi është bërë në bazë të procedurës standarde të punës me Urdhër Nr. 17, datë 10.01.2024, ku në këtë procedurë kërkohet që përmbajtja e këtij dokumenti të klasifikohet si sekret shtetëror dhe nuk mund të japim sqarime mbi këtë dokument”.

I ndodhur në këto kushte ku mendoj se më është privuar padrejtësisht një ndër të drejtat themelore të njeriut siç është ajo e arsimimit, si dhe ajo e infomimit nga ana e institucioneve shtetërore përkatëse.

Mendoj se jam i paragjykuar dhe i diskriminuar pasi ndaj meje nuk ka asnjë lloj vendimi gjykate ku unë shpallej fajtor për kryerjen e ndonjë vepre penale, nuk jam pyetur asnjëherë si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, ndaj meje nuk është marrë asnjë masë sigurimi personal.

Kërkoj ndihmën tuaj si mbrojtës i të drejtave të njeriut për sqarimin se ku është bazuar Komisarirati i Policisë Mallakastër për dhënien e Vërtetimit të Besueshmërisë negativ (i papërshtatshëm) ndaj meje.

Fillimi dhe pushimi i një Kundravajtje Penale ndaj meje mendoj se nuk është kusht vendimtar për privimin tim nga e drejta për tu arsimuar pasi unë kam dëgjuar në media me dhjetra dhe qindra raste ku punonjës të policisë së shtetit janë proceduar penalisht dhe janë në marrëdhënie pune.

Ligji duhet të jetë një dhe i barabartë për të gjithë. Në rastin tim ky ligj po përdoret me dy standarde. Jam në një gjendje të rënduar psikologjike, ndihem i diskriminuar dhe i fyer. Afati i fillimit të shkollës është shumë i shkurtër. Jam në gjendje ankthi, pres ndihmën Tuaj.”

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e DVP Fier.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar në mënyrë të shprehur mbrojtje në lidhje me shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1225/1 prot., datë 12.09.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes shkresës⁴ nr. 8407/1, datë 17.09.2024, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e saj sa i përket ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, duke sqaruar ndër të tjera se: *“...Z. M. Xh. Y., aplikant i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, ka qenë pjesëmarrës në konkurrimin për ndjekjen e Programit të Studimeve “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025.*

Pasi ka kaluar me sukses Testin fizik dhe kontrollin shëndetësor, i është nënshtruar verifikimit përfundimtarë lidhur me kriterin e besueshmërisë, parashikuar në nenin 38, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, strukturat kompetente të hetimit të krimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier kanë kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se është i përshtatshëm për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1225/2 prot., datë 18.09.2024.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit, pranë Akademisë së Sigurisë, me Vendimin nr. 2, datë 25.08.2024, ka vendosur kualifikimin e tij në procesin e konkurrimit, lënë në fuqi me Vendim nr. 9, datë 28.08.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Në vijim strukturat e hetimit të krimeve në Komisariatit e Policisë Mallakastër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, kanë bërë riverifikim të të dhënave për shtetasin M. Xh. Y. dhe u ka rezultuar se në datë 13.03.2024 ndaj këtij shtetasi ka filluar procedim penal për veprën penale “Keqpërdorim i thirrjeve telefonike” parashikuar nga neni 275 i K. Penal.

Në datë 21.08.2024 procedimi ndaj shtetasit M. Y. është pushuar konform ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistie”, hyrë në fuqi në 2.04.2024.

Me shkresën nr. 9345, datë 26.08.2024, Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka ridërguar vërtetimin e besueshmërisë sipas të cilit ky shtetas nuk gëzon besueshmëri, ka pengesa ligjore dhe nuk është i përshtatshëm, për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë.

Referuar nenit 139 dhe 140, të Rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2025, e ndryshuar, nëse aplikanti apo pjesëtar të familjes së tij, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit dhe skualifikohet nga procesi i konkurrimit.

Gjithashtu në urdhrin Nr. 1039, datë 23.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”, është përcaktuar se aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe integritetit.

Për rrjedhojë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi të dhënat e administruara, me Vendim Nr. 9/1, datë 29.08.2024, skualifikoi Z. M. Xh. Y., nga procesi i konkurrimit për ndjekjen e Programit të Studimeve “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025, pasi nuk plotëson kriteret ligjore të besueshmërisë”.

Gjithashtu, bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, DPPSH vuri në dispozicion të Komisionerit:

- Urdhrin nr. 965/1, datë 08.08.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për miratimin e procedurës standarde të punës për pranimin në Policinë e Shtetit”;
- Urdhrin Nr. 1039, datë 23.07.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”;
- Vendimin nr. 2, datë 25.08.2024, të Komisionit të Pranimit, “Për kandidatët që do të ndjekin programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”;
- Vendimin nr. 9, datë 28.08.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, “Për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve që do të ndjekin programin e Studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”;
- Vendim nr. 9/1, datë 29.08.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 9, datë 28.08.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”.

Në përgjigje përsa më lart, Drejtoria Vendore e Policisë Fier, përmes shkresës⁵ nr. 9942/1, datë 30.09.2024, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se aplikimi nga ana e M. Y. është bërë në portalin U-Albania dhe dosja e aplikantit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Përmes e-mail-it datë 23.09.2024, Komisioneri vuri në dispozicion ankuesit një kopje të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe kërkoi nga ana e tij parashtrime lidhur me to.

Në përgjigje sa më sipër, ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës,*

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1225/3 prot., datë 02.10.2024.

shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në shkaqet e pretenduara, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Mbështetur në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Urdhrit nr. 1039, datë 23.07.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”*, M. Y. ka konkurruar për të studiuar pranë Akademisë së Sigurisë.

Në nenin 135, të Rregullores për Policinë e Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, përcaktohen të gjitha fazat e konkurrimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë. Neni i sipërcituar parashikon: *“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:*

- a) testimit me shkrim;*
- b) testimit të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit;*
- ç) testimit psikologjik;*
- d) kontrollit shëndetësor;*
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit”*.

Rezultoni se M. Y. ka kaluar me sukses të gjitha fazat e konkurrimit për në Akademinë e Policisë, duke mbërritur në fazën e Verifikimit Përfundimtar. Në nenin 139, të Rregullores për Policinë e Shtetit miratuar me Vendimin nr. 750, datë 16.09.2015, të Këshillit të Ministrave, parashikohet se:

“1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimit të përcaktuar në nenin 135, germa “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.

2. Numri i aplikantëve që do t’i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurrim të përcaktuar në fillim të procesit.

3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.
4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.
5. Relacioni (lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 139, të sipërcituar, Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka kryer procedurat e verifikimit, nga ku ka rezultuar se shtetasi M. Y. është i përshtatshëm për t'u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Pranimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Vendimin nr. 2, datë 25.08.2024, ka vendosur kualifikimin e tij në procesin e konkurrimit, lënë në fuqi me Vendim nr. 9, datë 28.08.2024, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Në vijim, strukturat e hetimit të krimeve në Komisariatin e Policisë Mallakastër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, kanë bërë rivefikim të të dhënave për shtetasin M. Y. dhe u ka rezultuar se në datë 13.03.2024 ndaj këtij shtetasi ka filluar procedim penal për veprën penale “*Keqpërdorim i thirrjeve telefonike*” parashikuar nga neni 275 i K. Penal.

Në datë 21.08.2024 procedimi ndaj shtetasit M. Y. është pushuar konform ligjit nr. 33/2024, “*Për dhënie amnistie*”, hyrë në fuqi në 02.04.2024.

Me shkresën nr. 9345, datë 26.08.2024, Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka ridërguar vërtetimin e besueshmërisë sipas të cilit ankuesi nuk gëzonte besueshmëri, ka pengesa ligjore dhe nuk është i përshtatshëm, për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë.

Rregullorja e Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2025, e ndryshuar, në nenin 139, përcakton se: “1. Aplikanti që kalon me sukses procesin e testimit të përcaktuar në nenin 135, germa “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.

2. Numri i aplikantëve që do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është i njëjtë me kuotën për konkurrim të përcaktuar në fillim të procesit.

3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.

4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

5. Relacioni (lidhja 17) me dokumentacionin e çdo aplikanti fitues, i dërgohet Akademisë së Sigurisë”.

Në nenin 140, të Rregullores ku parashikohen “Rastet e skualifikimit”, përcaktohet se: “1. Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:

- a) nuk kalon testimin me shkrim;
- b) nuk kalon testimin e aftësive fizike;
- c) nuk kalon testin psikologjik;
- ç) nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit;
- d) ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara;
- dh) pas procesit të verifikimit përfundimtar rezulton se ai është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje.
- e) rezulton përdorues droge;
- ë) rezulton të ketë varësi nga alkooli.
- f) nuk kalon kontrollin shëndetësor ose gjatë këtij kontrolli evidentohen tatuazhe në pjesët e dukshme të trupit;
- g) nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.

2. Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrimit dhe kontrollit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurrimit dhe skualifikohet”.

Referuar nenit 139 dhe 140, të Rregullores së Policisë së Shtetit, sipërcituar, nëse aplikanti apo pjesëtar të familjes së tij, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit dhe skualifikohet nga procesi i konkurrimit.

Gjithashtu, në ndarjen I, pika 1/h) të urdhrin Nr. 1039, datë 23.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025”, është përcaktuar se aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe integritetit, për të aplikuar dhe ndjekur studimet pranë Akademisë së Sigurisë.

Për rrjedhojë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi të dhënat e administruara, me Vendim Nr. 9/1, datë 29.08.2024, skualifikoi ankuesin dhe 3 (tre) konkurrent të tjerë, nga procesi i konkurrimit për ndjekjen e Programit të Studimeve “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2024-2025, pasi nuk plotësonin kriteret ligjore të besueshmërisë.

Në vendimin Nr. 9/1, datë 29.08.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në faqen 2 të tij, citohet se: “Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni konstaton:

Për shtetasin M. Xh. Y.: Strukturat e hetimit të krimeve në Komisarriatin e Policisë Mallakastër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, pasi kanë verifikuar të dhënat për shtetasin M. Xh. Y., ka rezultuar se në datë 13.03.2024 ndaj këtij shtetasi ka filluar procedim penal për veprën penale “Keqpërdorim i thirrjeve telefonike” parashikuar nga neni 275 i K. Penal. Në datë 21.08.2024 procedimi ndaj shtetasit M. Y. është pushuar konform ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistie”, hyrë në fuqi në 02.04.2024. Me shkresën nr. 9345, datë 26.08.2024, Drejtoria Vendore e Policisë

Fier ka ridërguar vërtetimin e besueshmërisë sipas të cilit ky shtetas nuk gëzon besueshmëri, ka pengesa ligjore dhe nuk është i përshtatshëm, për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë”.

Mbështetur në përmbajtjen e Vendimit datë 20.08.2024, “Për pushimin e çështjes penale nr. 431, viti 2024”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton se ndaj ankuesit, M. Y., në datën 21.03.2024, pranë kësaj Prokurorie është regjistruar procedimi penal Nr. 431, në lidhje me veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

Më datë 04.04.2024, është miratuar Ligji Nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, i cili në nenin 6, “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale”, parashikon se: “1. Përrjashtohen nga ndjekja penale të gjithë personat që kanë çështje penale në hetim, çështje të pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31.3.2024, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara nga nenet 91, 96, në paragrafin e dytë të nenit 112, në nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, në paragrafin e parë të nenit 124/b, në nenet 125, 127, 204, 205, 206, 207, në paragrafin e parë të nenit 257/a, në nenet 269 dhe 318 të Kodit Penal.”.

Jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë, e cila përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe ose dënimeve përkatëse. Amnistia e veprës penale vepron përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit, me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer, ndërsa amnistia e dënimit ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit dhe të dënimeve plotësuese, edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndërsa amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm⁶.

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se akti i amnistisë parashikon disa organe të cilat, me hyrjen në fuqi të këtij akti (ligji për dhënie amnistie), marrin kompetencë për të përjashtuar nga ndjekja penale (*amnistia e veprës penale*), nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose për të bërë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë (*amnistia e dënimit*). Kështu, Prokuroria, që në kuptim të nenit 148/1 të Kushtetutës, është organi që ushtron ndjekjen penale dhe gjykata, që, në kuptim të nenit 42 dhe 135 të Kushtetutës, është organi kompetent që gjykon akuzat e ngritura ndaj individëve për vepra penale, me hyrjen në fuqi të ligjit për amnistinë, autorizohen të përjashtojnë nga ndjekja penale vepra penale të kryera sipas parashikimeve të këtij ligji. Për sa i përket përjashtimit nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit, ose zëvendësimin të tij, organet

⁶ Vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 16, datë 19.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese

kompetente janë ato të parashikuara nga ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, i ndryshuar⁷.

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, me Vendimin datë 20.08.2024, “Për pushimin e çështjes penale nr. 431, viti 2024”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, vendosi: Pushimin e procedimit penal Nr. 431 të vitit 2024, për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

Referuar Vendimit datë 20.08.2024, “Për pushimin e çështjes penale nr. 431, viti 2024”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në faqen 4, paragrafi i fundit të tij, citohet se: “...Në këto kushte, veprimet e tij të kundraligjshme do të kualifikohen në kuadër të Nenit 275 të Kodit Penal. Kështu vepra penale, në paragrafin e saj të parë, parashikon në maksimumin e saj dënimin “me gjobë ose me burgim gjer në 1 vit”...”.

Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri vëren se ndaj ankuesit, M. Y. është pushuar procedimi penal i nisur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe si pasojë është përjashtuar nga ndjekja penale, përmes përfitimit nga parashikimet e Ligjit Nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”.

Komisioneri vlerëson se amnistia penale, është një akt ligjor, që përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Në thelb, amnistia është një formë e faljes nga shteti për vepra penale të caktuara, duke u mundësuar individëve një mundësi për të rifituar lirinë, për tu përjashtuar nga ndjekja penale ose për të pastruar rekordet e tyre të mëparshme penale. Pra, në rastin konkret, Komisioneri vëren se fakti që një person përfiton nga ligji “Për dhënie amnistie”, në vetvete përjashtohet nga dënimi apo ndjekja penale, por kjo nuk lidhet me deklarinimin e tij fajtor ose jo.

Në nenin 38, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Pranimi në Akademinë e Sigurisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur.

2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil.

c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;

d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;

dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;

⁷ Vendimi nr. 16, datë 19.04.2010, i Gjykatës Kushtetuese

- e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B;
- f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.
- g) të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurrimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm.”

Në zbatim të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, Rregullorja e Policisë së Shtetit, në nenin 139, përcakton se: “...3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës.

4. Verifikimi kryhet nga strukturat vendore dhe qendrore të hetimit të krimit, sipas procedurave të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit...”.

Ndërsa në nenin 140, pika 1/g, të Rregullores, përcaktohet se: “1. Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:...g) nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.”

Në analizë të informacionit dhe akteve ligjore sipërcituar, Komisioneri vëren se në thelb, amnistia është një formë e faljes nga shteti për vepra penale të caktuara, duke u mundësuar të dënuarve ose personave të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, një mundësi për të rifituar lirinë ose për të pastruar rekordet e tyre të mëparshme penale. Në këtë kuptim, fakti që ankuesi ka përfituar nga parashikimet e Ligjit Nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, nuk lidhet me deklarimin fajtor ose jo, por me ndërprerjen e procedimit penal të nisur ndaj tij.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri do të vlerësojë nëse një diferencë e tillë justifikohet objektivisht, pra specifikisht:

- A ndjek një qëllim legjitim?
- A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme, proporcionale me qëllimin e ndjekur?

- **Së pari, Komisioneri do të vlerësojë nëse një diferencë e tillë, ndjek një qëllim legjitim.**

Referuar informacionit dhe legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimit e strukturave të Policisë së Shtetit, evidentohet se qëllimi dhe synimi i hartimit të këtyre akteve është ndër të tjera, respektimi i parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit. Gjithashtu, përmes këtyre akteve, synohet që punonjësi i policisë të ofrojë standarde të larta dhe të udhëhiqet nga përgjegjshmëria, përkushtimi, profesionalizmi, sjellja etike, korrektësia dhe zbatimi i ligjit.

Sa më sipër, evidentohet se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me Urdhrin Nr. 1039, datë 23.07.2024, ka hapur fazën e aplikimeve për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, duke vendosur ndër të tjera dhe kriteret e konkurrimit. Në ndarjen I.I., pika 1/h) të urdhrit është përcaktuar se aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe integritetit, për të aplikuar dhe ndjekur studimet pranë Akademisë së Sigurisë. Sipas këtij përcaktimi,

Në nenin 6, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, parashikohet se: “...30. “Vërtetimi i besueshmërisë” është dokument i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i cili pasqyron rezultatet e verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar në raport me ato të regjistruara fizikë dhe elektronikë të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që lëshohet nga autoritetet vendore të Policisë së Shtetit, për shtetasin/personin, i cili pranohet apo rikthehet në Policinë e Shtetit...”.

Në nenin 38, pika 2/f të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, parashikohet se: “ 2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë: ...f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë”.

Në zbatim të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, Rregullorja e Policisë së Shtetit, në nenin 139, përcakton se: “...3. Në rast se aplikanti ose pjesëtarë të familjes së tij, pas verifikimit përfundimtar, rezultojnë të implikuar në veprimtari kriminale, ai skualifikohet dhe procesit të verifikimit përfundimtar i nënshtrohet kandidati i radhës, i renditur në listën e rezultateve, sipas rendit zbritës...”.

Neni 127, i Rregullores për Policinë e Shtetit, përcakton se: “1. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, mbi bazën e nevojave, shpall periudhën e aplikimit, programin e konkurrimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim në Akademinë e Sigurisë, fazat e konkurrimit, si dhe kuotat e pranimit. 1/1. Bazuar në nevojat e identifikuar të Policisë së Shtetit, shpallen kuotat e aplikimit për pranim në Akademinë e Sigurisë edhe për shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 38, të ligjit për Policinë e Shtetit dhe kriteret e veçanta në bazë të nevojave të Policisë së Shtetit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike...”.

Ndërsa në nenin 140, pika 1/g, të Rregullores, përcaktohet se: *“1. Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:...g) nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit.”*

Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, për tu bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka të drejtën dhe detyrimin të shpall periudhën e aplikimit, programin e konkurrimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim në Akademinë e Sigurisë, fazat e konkurrimit, kuotat e pranimit dhe kriteret e veçanta në bazë të nevojave të Policisë së Shtetit.

Në këtë kuptim, hartimi i kriterëve specifike mbështetur në nevojën, për të rekrutuar punonjës në strukturat e Policisë së Shtetit Policisë, ndjek një qëllim të ligjshëm, referuar përcaktimeve të sipërcituara.

Në analizë përse më sipër, pyetja që lind është: A kemi në këtë rast një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet?

Sipas nenit 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.
- I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe
- Në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktajnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”*

Nevoja apo synimi për të rekrutuar punonjës në strukturat e Policisë së Shtetit Policisë, të cilët duhet të gëzojnë besueshmëri përbën një qëllim të rëndësishëm, por a është ky kriter kufizues mjeti i duhur i përdorur sipas parashikimit të nenit 12/2 të KPA, për të arritur këtë qëllim? A ka mjete të tjera të cilat mund të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të arritur këtë qëllim, pa cenuar të drejtën për mundësi të barabarta në punësim, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të konkurrojnë për punonjës të Policisë së Shtetit.

Nga provat dhe informacioni i vënë në dispozicion nga palët, rezulton që:

- në datën 21.03.2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ndaj ankuesit ishte regjistruar procedimi penal Nr. 431, në lidhje me veprën penale “*Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike*”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal;
- në datë 06.08.2024, ai ka aplikuar për të vazhduar studimet e larta në Akademinë e Sigurisë;
- me Vendimin datë 20.08.2024, “*Për pushimin e çështjes penale nr. 431, viti 2024*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, rezulton se, ankuesi ka përfituar nga parashikimet e Ligjit Nr. 33/2024 “*Për dhënie amnistie*”.

Në analizë të informacionit dhe akteve ligjore sipërcituar, Komisioneri vëren se në thelb, pavarësisht se ankuesi ka përfituar nga amnistia dhe çështja penale ndaj tij është pushuar e nuk ndiqet më nga ana e prokurorisë dhe organeve gjyqësore, rezulton që gjatë periudhës së aplikimit pranë Akademisë së Sigurisë, ai ka qenë person i dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Në këtë, kuptim edhe pse ankuesi prezumohet i pafajshëm deri në momentin që organet gjyqësore të shprehen me vendim të formës së prerë, fakti që ai ka qenë person në ndjekje penale gjatë kohës që ka aplikuar pranë Akademisë së Sigurisë, vjen në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara. Komisioneri vlerëson se për këta persona nuk ka një vendim gjykate që të vendosë për fajësinë apo jo të tyre. Si pasojë veprimi i ndërmarrë nga Komisioni i Pranimit të DPPSH-së kundrejt ankuesit vlerësohet nga Komisioneri si i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të informacionit, vlerëson se vendimi i marrë nga Komisioni i Pranimit të DPPSH-së kundrejt ankuesit, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Në nenin 17/2 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji*”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32 dhe 33, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të M. Y. për shkakun e pretenduar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)
(Fusha: Arsim)